

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare
“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN
E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”
24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri

SFIDA PËR NJË EDUKIM FINANCIAR CILËSOR NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR

Anxhela Hodaj¹
Aurela Mucaj²

Abstrakt

Në ditët e sotme, në kushtet e globalizimit, të një mjedisi dinamik, fleksibël dhe një konkurrence të ashpër, edukimi financiar po shikohet gjithnjë e më shumë si një sfidë. Duke marrë parasysh se jetojmë në një kohë të paqëndrueshme ekonomike, gjithnjë e më tepër po vihet re rëndësia që ka edukimi financiar në jetën e njerëzve, por sidomos tek të rinjtë. Suksesi dhe qëndrueshmëria financiare mund të jetë shumë më e thjeshtë për t’u arritur nëse ndërtohet mbi baza financiare të marra që në fazat e para të edukimit.

Problematika kryesore në këtë punim lidhet me zhvillimin e dobët të edukimit financiar, në një kohë që siguria financiare nuk është e qëndrueshme. Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë nivelin në të cilin është i zhvilluar edukimi financiar aktualisht, të evidentojë përmasën e ndikimit që ka zhvillimi i edukimit financiar si dhe të evidentojë nevojën e edukimit financiar gjatë gjithë jetës së njerëzve, për vetë rëndësinë që financat kanë tek individët, dhe sidomos në arsimin parauniversitar, e konsideruar si një periudhë shumë e rëndësishme për formimin bazë të individëve.

Pyetjet kërkimore më kryesore të punimit janë:

1. Sa i rëndësishëm është edukimi financiar në nivelin parauniversitar?
2. Cila do të konsiderohej si periudha më e përshtatshme për të zhvilluar kurrikula për edukimin financiar të të rinjve në arsimin parauniversitar?

Për t’i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore, përveç rishikimit të detajuar të literaturës jemi bazuar edhe në pyetësorë të zhvilluar me studentët e Universitetit të Tiranës, veçanërisht studentët e Fakultetit të Ekonomisë, si një pikë kyçe për evidentimin e problemeve kryesore dhe njëkohësisht të zgjidhjeve të mundshme për të nxitur zhvillimin e edukimit financiar si një mënyrë për të garantuar njohuri të dobishme dhe qëndrueshmëri financiare.

Fjalë kyçe: *Edukim financiar, sfida, paqëndrueshmëri ekonomike, zhvillim, qëndrueshmëri financiare, financa personale.*

¹ anxhelahodaj@yahoo.com Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Master Shkencor Kontabilitet dhe Auditim

² aurelamucaj@gmail.com Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Master Shkencor Kontabilitet dhe Auditim